



Republika e Kosovës Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Odelenje za Budžet i Finansije-Department of Budget and Finance

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2025

Përmbajtja

HYRJE.....	3
1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA.....	3
2. BUXHETI 2025.....	4
3. PUNËT E REALIZUARA JANAR - QERSHOR	4
4. JANAR- QERSHOR - BUXHET,ALOKIM,SHPENZIM	5
4.1 Paraqitja grafike.....	5
5. TË HYRAT VETANAKE	6
6. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË	6

HYRJE

- Ky raport përfshinë të dhënat për periudhën Janar- Qershor 2025 nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, konkretisht nga sektori për Buxhet dhe Financa dhe sektori i Tatimit në Pronë.

1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë, ne si drejtori konsiderojmë se kemi kryer të gjitha detyrat dhe obligimet që i takojnë kësaj drejtorie.
- Në Drejtorin e Financave kemi arritur që detyrat të kryhen në afate ligjore dhe çdo e hyre dhe shpenzim të evidentohet, në sistemin e SIMFK dhe data bazën e brendshme.
- Gjate kësaj periudhe jemi ballafaquar edhe me zbatimin e kontratës kolektive në arsim, me ekzekutimin e urdhërave përmbartimorë nga ana e thesarit për këtë lloj destinimi, ku vlera e këtij shpenzimi arrinë përafërsisht 2 milion euro, mjete të cilat janë tërhequr nga kategoria e investimeve kapitale, mallra dhe shërbime dhe shpenzimet Komunale, gjë që na ka zvogëluar buxhetin në masë të konsiderueshme.
- Gjithashtu kemi mbajtur disa takime me Ministrinë e Financave, me AKK dhe organizata të ndryshme apo donator që kryesisht janë trajtuar çështjet financiare.
- Tek shpenzimet Operative kemi arritur të kursejmë disa shpenzime pa e dëmtuar procesin e punës, duke i rritur disa shpenzime-shërbime të cilat në të kaluarën janë paguar nga Kapitalet e realisht kanë qenë Mallra dhe Shërbime, siç janë, mirëmbajtja e ndërtesave , mirëmbajtja e rrugëve, sinjalizimet horizontale dhe vertikale, rrënimet e ndërtimeve pa leje, hartimi i projekteve, mbikëqyrje projekteve etj, duke respektuar kodet dhe kategoritë ekonomike, si dhe afate ligjore të cilat janë të rregulluara me ligjet për Financat Publike.

2. BUXHETI 2025

➤ Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2025 ndahet në dy fonde burimore:

- Grandi i qeveritar18,981,085.00 €
- Të hyrat vetanake2,001,711.00 €
- Gjithsej:.....20,982,796.00 €

➤ Buxheti final për vitin 2025 i shpërndarë sipas kategorive ekonomike:

- Paga dhe Mëditje10,746,449.00 €
- Mallra dhe Shërbime.....2,811,100.03 €
- Shpenzime Komunale390,000.00 €
- Subvencione dhe Transfere1,060,000.00 €
- Investime Kapitale.....6,721,007.46 €
- Total:21,728,556.49 €

3. PUNËT E REALIZUARA JANAR - QERSHOR

➤ Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar këto detyra:


- Zotime, pranime, shpenzime për mallra dhe shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere, dhe investime kapitale dhe përgatitja e ndryshimeve në listën e pagave për punëtor.
- Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025.
- Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë
- Përgatitja e raportit financiar në baza tremujor 2025 për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës.
- Raportimi i obligimeve financiare, dhe kontraktuale në baza mujore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore (shpenzimet dhe të hyrat) për publikim në Web faqen e Komunës së Rahovecit.

4. JANAR- QERSHOR - BUXHET,ALOKIM,SHPENZIM

Përshkrimi	Lëndët e kryera	Buxheti fillestar	Buxheti final	Alokimet	Shpenzimet	Shpenzim/ Buxheti final %	Shpenzim /Alokim %
Paga dhe Mëdtije	-	10,746,449.00	10,746,449.00	5,559,630.92	4,647,296.80	43.24%	83.59 %
Mallra dhe Shërbime	931	2,590,408.00	2,811,100.03	2,665,502.03	2,064,771.00	73.45%	77.46 %
Shpenzime Komunale	240	390,000.00	390,000.00	390,000.00	204,195.21	52.36%	52.36 %
Subvencione dhe Transfere	87	1,010,000.00	1,060,000.00	445,087.87	443,548.04	41.84%	99.65 %
Investime Kapitale	89	5,254,228.00	6,721,007.46	6,234,672.88	4,858,325.80	72.29%	77.92 %
Totali	1347	18,981,085.00	21,728,556.49	15,294,893.70	12,218,136.85	56.23%	79.88 %

- Sqarim: Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është për arsye të bartjes së mjeteve të mbetura nga viti 2024, Donacionet dhe Grantet.

4.1 Paraqitja grafike



5. TË HYRAT VETANAKE

- Të hyrat e përgjithshme vetanake të planifikuara për vitin 2025 janë 2,001,711.00 euro, për këtë periudhë janë realizuar në shumë 950,330.26 euro apo 47.48% të planifikimit vjetor.

6. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

- Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025 sektori i tatimit në pronë ka realizuar të hyra në shumë prej 256,842.02 euro apo 45.26 % vjetor (planifikimi vjetor 567,464.00) ndërsa tatimi në tokë ka realizuar të hyra prej 276,611.09 euro apo 142,632.09 tejkalim të planit vjetor (planifikimi vjetor 133,979.00).
- Regjistrimet e reja janë 204 objekte, ose 36,930 m2. Verifikimi i objekteve 1918 ose 310,938 m2.

-Vërejtje: Të gjitha të dhënat që janë të paraqitur janë përgatitur në bazë të raporteve deri me 04.06.2025

Drejtoria për Buxhet dhe Financa
